

Për forcimin e individualitetit

artistik në dirigjim

Krahas arritjeve të mira sasiorë dhe cilësore të krijimtariisë sonë muzikore, forcimit dhe thellimit të karakterit realist, aktual e kombëtar të saj, vitet e fundit, sidomos pas Plenumit IV të KQ të PPSH dhe fjalës së 20 dhjetorit të vitit 1974 të shokut Enver, vërehen arritje të suksesshme edhe në fushën e interpretimit. Kontributi i dirigjentëve tanë, në sajë të rritjes së nivelit kulturor dhe muzikor të masave po vlerësohet gjithnjë e më shumë tek ne. Individualiteti krijues i secilit po spikat gjithnjë e më qartë në interpretimet e shumta e me interes artistik që ato bëjnë, duke tërhequr kështu vëmendjen dhe interesimin e vazhdueshëm të artdashësve. Dëgjuesit dhe spektatorët tanë dallojnë tek njëri e tjetri cilësi e shprehur në veçanti të dirigjentëve tanë udhëhiqen nga botëkuptimi marksist-leninist, nga koncepti materialist për jetën, artin dhe misionin e tij. Në të njëjtën kohë, edhe në fushën e dirigjimit, metoda e realizimit socialist hap fushë të gjerë për individualitetet krijuese.

Rruga e qëllimi i artit të dirigjimit tek ne është krejtë ndryshëm nga ai i artit borgjezo-revizionist. Shumë estetë borgjezë nevojën dhe rolin e dirigjentit e të dirigjimit në përgjithësi si shkollë e degë e veçantë, që u kristalizua në gjysmën e dytë të shek. 19 - të, e lidhin vetëni me rritjet strukturale të formave të mëdha të muzikës, duke injoruar kështu me paramendim faktorë të tillë të rëndësishëm me karakter social-estetik, siç janë zhvillimi dhe pasurimi i përmbajtjes të veprave muzikore që përcaktuan ato ndryshime strukturale, po kështu dhe rolin e dirigjentit për zbulimin dhe transmetimin në mënyrë të organizuar e krijuese të këtyre vlerave të mëdha ideoartistike.

Në vendin tonë, ku në sajë të udhëheqjes së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë po lulëzon e rritet i fuqishëm një art dhe muzikë thellësisht realiste dhe kombëtare, me një tendencë të qartë për edukimin ideoestetik e revolucionar të masave, të klasës punëtore, fshatarësisë kooperativiste e rinisë, nevoja e përgatitjes dhe e sigurimit të dirigjentëve në lartësinë e këtyre kërkesave është bërë një domosdoshmëri jetike. Me punën e madhe për ekzekutimin e veprave të kompozitorëve tanë që nga kënga e thjeshtë e deri te simfonia, opera dhe baleti, ata, si gjithë interpretuesit, janë bërë bashkëkrijues të zellshëm, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në evidentimin e vlerave më të mira të të gjithë këtyre veprave, tipareve e shprehive socialiste e kombëta-

re të tyre, shprehive stilistike dhe individuale të vetë kompozitorëve, duke ndihmuar në njohjen dhe propagandimin e tyre në masat punonjëse. Por, me gjithë hapat e mira që janë bërë, nuk kanë munguar edhe raste kur vepra e pjesë të ndryshme muzikore nuk i jepen dëgjuesit dhe spektatorit me tërë vlerat e tyre ideoemocionale dhe ideoartistike. Një gjë e tillë nganjëherë vihet re edhe në pjesë të veçanta të shfaqjeve skenike e koncertale të Teatrit të Operës dhe të Baletit, në ndonjë pjesë të shfaqjeve në aksione artistike kryesore, siç janë Koncertet e Majit në Tiranë, Festivali kombëtar i këngës në Radio-Televizion, por më shumë në ekzekutimin e këngës dhe të muzikës në estradat tona. Një e mëte e tillë, përveç të tjerave, ka të bëjë me punën e dirigjentit ndaj krijimtarisë dhe veprës që ekzekuton. Në këtë punë është i domosdoshëm uniteti organik i «unit» krijues të dirigjentit me atë të kompozitorit që, në artin dhe muzikën tonë - (ndryshe nga arti borgjezo - revizionist me tendencë të theksuara subjektivistike e formaliste) - udhëhiqet nga vetë faktorët ideologjikë, estetikë dhe artistikë, që përbëjnë drejtimit kryesore realiste e kombëtare të muzikës sonë dhe rolin të saj në shoqërinë tonë. Megjithë ndonjë të metë, tek ne ka bashkëpunim ndërmjet dirigjentit dhe kompozitorit, harmonizim dhe shkrirje të tyre të plotë në kuadrin e një bashkëpunimi krijues konstruktiv. Në praktikë kjo do të thotë që vepra me idetë e përmbajtjen e saj, me karakteristikat dhe tiparet e saj më të hollësishme («evdekur» siç është në partiturë) të hidhet në jetë, mbi bazën e saj reale, në lartësi të reja, nganjëherë të panjohura dhe nga vetë kompozitori dhe që burojnë nga forca e talentit, shprehitë krijuese, aftësitë përgjithësuese dhe ndërtuese të dirigjentit, për të komunikuar me dëgjuesit dhe spektatorët. Që të arrihet këtu, dirigjentit i duhet një proces i gjatë pune e djerse me veprën që do të ekzekutojë. Ky proces zhvillohet mbi bazën e njohjes e të analizës së hollësishme të përgjithësimit dhe të harmonizimit të plotë të elementëve e tipareve pozitive, të zbulimit të vlerave ideo dhe artistike Kështu, edhe spektatori më i thjeshtë me ndjenjën e tij muzikore arrin të kuptojë jo vetëm veprën, por edhe rolin e vërtetë të dirigjentit, personalitetin e individualitetin e tij krijues. Në raste të tilla interpretimesh të arrira, që tek ne nuk janë të rralla, spektatori arrin të bindet e të mësojë nëpërmjet veshit dhe ndjenjës së tij muzikore, se është pikërisht ky njëri që, me

orkestrën dhe me kolektivat e tjera ekzekuton muzikë, që i ngre ata në një forcë të gjallë, duke e përsosur veprën goftë në sensin teknik, goftë në atë ndjesor në një figurë të plotë. Kjo ndodh më shpesh me vepra që dirigjentit i japin dorë për të evidentuar para dëgjuesve shprehitë individuale si interpretues. Është një qëndrim i drejtë përpjekja e dirigjentit për vepra të realizuara në kuptimin e gjithanshëm të fjalës që justifikojnë me art kërkesat realiste kombëtare të muzikës sonë, për vepra me vlera edukuese dhe milituese, duke mos u nisur nga faktorët subjektivë dhe të kuptuarit në mënyrë të njëanshme të punës së dirigjentit për të ekzekutuar edhe ndonjë vepër që nuk i ka përmbushur plotësisht këto kërkesa.

Me forcimin e individualitetit artistik në dirigjim në funksion të krejt forcimit të karakterit realist, kombëtar e militant të muzikës së ekzekutuar, lidhet ngushtë edhe pjesëmarrja aktive e çdo dirigjenti në këshillat artistike, ku ai të thotë me kompetencë e përgjegjësi fjalën e vet për ndërtimin e repertorit, programit të shfaqjes etj. Me mundësitë ideo-profesionale, me argumentimet objektive të tyre, të nisur nga qëndrimet parimore të drejta, ata mund të japin një ndihmë të madhe në diskutimet gjatë procesit të gjykimit. Po kështu, me argumentime bindëse, propozime të studjuara dhe të matura ata mund të ndihmojnë edhe krijuesit-kompozitorë, për ndreqjen e mungesave të karakterit artistik kur kanë të tilla veprat. Në këtë mënyrë dirigjentët nuk mbeten si ekzekutues të njëanshëm, jashtë problematikës së repertorit të institucioneve dhe të kolektivave artistike, nga ana tjetër as nuk e zbehin sadopak përgjegjësinë kryesore për këto çështje të udhëheqësve artistikë, por u japin atyre një ndihmë të çmueshme. Kjo do të mënjanonte në një farë mase edhe ato raste luhatjesh që vihen re nganjëherë nëpër koncerte e shfaqje, kur në një program disa pjesë ekzekutohen me nivel më të mirë, disa jo, sepse kuptohet që nuk janë miratuar plotësisht nga ana e tij. Në një rast të tillë nuk ka marrëdhënie të drejta e bashkëpunim konstruktiv ndërmjet dirigjentit dhe autorit. Po cila do të ishte zgjidhja? Ajo mendojmë se nis me atë që dirigjenti duhet të ketë të qartë e të ketë krijuar bindje të plotë se akcila pjesë, pavarësisht nga ndonjë e metë e dobësi e karakterit profesional, ka vlera të tilla që u shërben dëgjuesve dhe spektatorëve, i edukon ata. Kështu dirigjenti, i udhëhequr nga ky kritere bazë, mund dhe duhet të ndihmojë për të mënjanuar ato të

meta, çuke e dhënë veprën në nivel artistik dinjitoz. Raste të tilla në praktikën e dirigjentëve tanë ka patur gjithashtu. Dhe janë pikërisht keto që duhen përgjithësuar.

Për interpretimin me nivel të lartë ideoartistik të veprave dhe për arritjen e atyre shprehive që përcaktojnë figurën e plotë e të gjithanshme të dirigjentit dhe disa veçanti krijuese individuale nga ana e tij, roli i orkestrës dhe kolektivave që drejton, zënë një vend shumë të rëndësishëm. Në përgjithësi punohet me frymë kolektive, në mënyrë të përbashkët, ndonëse edhe këtu duhet luftuar kundër ndonjë shfaqjeje a koncepti ku puna e dirigjentit lidhet në mënyrë të njëanshme me «unin» e tij, kryesisht me lavdinë e tij personale.

Dirigjenti ynë, ndryshe nga ata të vendeve borgjezo - revizioniste, për vetë kërkesat parimore të krijimtarisë sonë duhet ta mendojë kolektivin si një masë të ndërgjegjshme për çka dhe çfarë luan, këndon dhe interpreton, të vetëdijshme për kërkesat që vihen deri në hollësitë më të vogla, si një njësi kompakte luftarake me një psikologji, mendim krijues dhe frymëzim të bukur që përbëjnë kushin themelor për ta kthyer atë unitet ideal gjatë provave, në një unitet real gjatë ekzekutimit publik.

Ndodh nganjëherë që edhe pjesëtarë të kolektivit orkestral të kenë një kuptim të ngushtë në teori dhe në praktikë për raportin dirigjent - orkestrë, mbi rolin determinues të dirigjentit për ekzekutimin. Si rrjedhim, përpjekja për të arritur shkalën sa më të lartë në ekzekutim dhe përsosmërinë zbrër thjesht në nevojën e përvetësimit teknik të materialit, të cilin nganjëherë e shikojnë në plan individual, duke mos marrë parasysh kështu më kryesoren: domosdoshmërinë e arritjes kolektive të atij rezultati e figure artistike që përmendim më sipër dhe që kërkon mund e zjersë, disiplinë të lartë artistike.

Personaliteti i dirigjentit dhe figura e tij është e lidhur ngushtë me punën pedagogjike që ai duhet të bëjë për forcimin dhe konsolidimin e vazhdueshëm ideo-profesional e të rritjes së mjeshtërisë ekzekutive të të gjithë kolektivit orkestrës apo të korit. Në ekzekutimin e orkestrave dhe të koreve profesioniste, atyre të estradave dhe të ansambleve artistike të ndryshme nga një shfaqje e koncert në jetrin, gjendemi shpesh para luhatjesh të nivelit të tingëllimit. Prandaj forcimi i mëtejshëm i punës ideo-pedagogjike dhe profesionale me kolektivat, forcimi i regjimit të punës dhe i disiplinës artistike me ta, i provave të plota dhe të ngjeshura, i studimit individual të pjesëtarëve dhe i kërkimit të llogarisë, mbetet një detyrë kryesore për dirigjentët tanë. Kësë nevojë e dikton edhe fakti që rendimenti i këtyre kolektivave për sa u përket premiërave të reja ka raste që nuk është në shkallën e duhur, në një kohë kur dita - ditës në gjirin e tyre po hyn elementi i përgatitjes edhe me shkollë të lartë dhe që tashmë përbën bazën kryesore. Problemi duhet parë sidomos lidhur me orkestrat e estradave profesioniste, me orkestrat frymore, sidomos në formacionet korale e komplekset vokale të rretheve. Në këto të fundit ne kemi traditë të mira, të

(vijon në f. 10)

Mustafa Krantja

Artist i merituar